**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

## Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

**Adresa:Rr .Isa Boletini pn. tel.; +381 (0)280 23 603 ,e-mail : dshcs@gjilani-komuna.org**

**LISTË DISTRIBUIMI/CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP/**

| | |
|---|---|
| **REFERENC-Ë:** | **SH. Z nr.** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kryetarin e Komunës z.Lutfi Haziri** |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | **Drejtor i DSHMS – Nexhat Hajrullahu** |
| **TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:** | **Raport pune Janar-Mars 2016** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Zyrës:<br>Br. Kancelarije:<br>Room No: | | Lokacioni:<br>Lokacija:<br>Extencion: | | Data:<br>Datum:<br>Date: | **26.04.2016** |

| | |
|---|---|
| Për aktivitet/Za aktivnost/For action/ | ☐ |
| Për miratim/Za usvajanje/For aproval/ | ☐ |
| Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/ | ☐ |
| Për komente/Za komentare/For comments/ | ☐ |
| A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May ëe discuss/ | ☐ |
| Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/ | ☐ |
| Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/ | ☐ |
| Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/ | ☐ |
| Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Notes and responses/ | ☐ |
| Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/ | **x** |
| Afati/ Rok/Deadline/ | |

I nderuar Kryetar,

Kemi paraqitur në pika të shkurtra angazhimin tonë si Drejtori e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku jemi përqendruar shkurtimisht të pasqyrojmë punën tonë për periudhën tre mujore Janar- Mars 2016.

DSHMS- është angazhuar në vazhdimësi në kujdesin e shëndetit publik duke synuar gjithnjë përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe në sferën e mirëqenies dhe shërbimeve sociale. Nga skema për subvencionimin e personave me probleme shëndetësore, familjarëve ose të afërmëve të tyre, që lidhet me nevojën e mjekimit dhe trajtimit shëndetesor të tyre**,** në DSHMS janë parashtruar dhe shqyrtuar **226** kërkesa për barëra dhe mjekime, nga të cilat **34 janë referuar** për Ministri të Shëndetësisë, ku ndihma në barna dhe trajtim shëndetësor kap vlerën **17.190 euro**, që është një rritje e vogël në krahasim me vitin e kaluar.

Gjithashtu është pasqyruar edhe epilogu i këtyre kërkesave si dhe vlera financiare e përgjithshme e shpenzuar në emër të tyre, duke krahasuar shifrat me vitin paraprak.

**Vlen të theksohet se sa i përket shërbimeve shëndetësore ka një rritje cilësore dhe kuantitative (sasiore) duke arritur një mbulueshmëri mjaft të mirë të terrenit, falë edhe projektit të përbashkët me CARITAS-in.**

**Shërbimet sociale gjithashtu kanë pasur kujdesin e vazhdueshëm, ku përveç shërbimeve në qendër, vazhdojmë me blerje të shërbimeve nga Shoqatat për nevoja të veqanta, Liria, Pema etj, ku kryesisht jemi të kënaqur me bashkpunim.**

## Zyra Administrativo – Juridike

Zyra Administrativo – Juridike në vitin kalendarik **2016** ka filluar me zbatimin e planit të punës të aprovuar për vitin : **2016**. Kjo zyrë gjatë periudhës **tremujore JANAR- MARS** ka zhvilluar këto aktivitete në svera të ndryshme:

**<u>Nga sfera legjislative</u>**:

Ka bërë zbatimin e të gjitha ligjeve në fuqi nga lëmi i shëndetësisë, Rregulloreve, Udhëzimeve, Qarkoreve dhe Vendimeve të ndryshme, si: Udhëzimi Administrativ i Shëndetësis,**02/ 2015**, mbi Organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH)). Statuti i QKMF-së i hartuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë unik për të gjitha Komunat e Kosovës.

Janë hartuar shkresa,vendime, aktvendime, dhe procese të ndryshme për nevoja të Drejtoratit dhe shërbime tjera në kuadër të Komunës dhe QKMF-së.

**<u>Nga sferat tjera</u>**

Zyra Administrative ka kryer edhe punë tjera si:

Vizita të ndryshme në teren si anëtar i komisionit, në periudhën 3 /tremujore/ janë hartuar, vendime,dhe aktvendime për ndihmë në barëra, qëra, për zyrën e Kryetarit dhe raste për familjet nga Kumanova, të cilat po i japim në vazhdim:

**Paraqitja në mënyrë tabelare e vendimeve të hartuara nga: Z.Administrative.**

| Totali | Për barëra | aprovime | refuzime | Për qëra | Për zyrën e Kryetarit | Për familjet e zhvendosura | Të ndryshme |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **226** | **190** | **142** | **48** | **1** | **7** | **//** | **29** |

Zyra Administrative ka qenë e angazhuar edhe në komisione të ndryshme si në inspektimin e insititucioneve shëndetsore në shëndetësinë primare, vizita të rasteve sociale, në komisione të ndryshme të formuara nga institucionet komunale.

Zyra juridike ka ofruar edhe këshilla profesionale për nevoja të shërbimeve të drejtoratit e më gjërë,si dhe shërbime tjera sipas nevojës.

Zyra e shërbimeve shëndetësore në tremujorin e parë të vitit dymijë e gjashtëmbëdhjetë kohën më të madhe nga orari i punës ia ka kushtur përgaditjes dhe procesimit të kërkesave të qytetarëve nga rastet kur adresohen për ndihmë shëndetësore dhe nëse për ata vëndoset një përgjigjëje pozitive

(të ndihmohen financiarisht).

Numri kërkesave për ndihmë në raste të nevojës për mjekim dhe trajtim shëndetësor në perioden paraprake (tremujorin e vitit 2016) ka shënuar një rritje të theksuar. Përfundimisht me muajin mars 2016 në DSHMS kanë arritur dhe janë shqyrtuar 260 kërkesa,në këtë numër janë të përfshira edhe kërkesat e mbetura nga muaji dhjetor 2015.

Numri i kërkesave që përfundimisht me muajin mars janë mbyllur (janë ndihmuar pra!) është 139 kërkesa ndërsa shpenzimi në emër të tyre ka arritur në 13.900€.

Në ndërkohë edhe gjashtëdhjetë e nëntë (69) kërkesa të kësaj natyre që janë futur në DSHMS gjatë muajit mars, janë shqyrtuar nga komisioni dhe për 42 kërkesa prej tyre është propozuar ndihma dhe procesvërbali i është kaluar Kryetarit të Komunës për aprovim. Shpenzimi i propozuar për kërkesa të muajit të fundit është 3290€.

**ZYRA E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE**

Në vazhdim me anë të një shënimi krahasues paraqitet numri i kërkesave për periodën Janar-Mars 2016 krahasuar me të njejtin interval kohor të viteve 2015 përkatësisht 2014.

| Viti | Perioda 2 mujore | Perioda 3 mujore | Perioda 4 mujore | Perioda 6 mujore | Perioda 8 mujore | Shpenzimi në euro! |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2016 | 139 kërkesa | 182 kërkesa | | | | 17.190 |
| 2015 | 60 kërkesa | 122 kërkesa | | | | 10370€ |
| 2014 | | 90 kërkesa | | | | 6110€ |

Sipas evidencave dhe shënimeve që mbajmë një numër i konsiderueshëm i kërkesave vijnë nga raste tani më të njohura për ne (raste që na janë drejtuar dhe janë ndihmuar edhe në vitet paraprake, njerëz me probleme shëndetësore kronike).

Nga 182 raste që komisioni komual ka vlersuar se meritojnë të ndihmohen 43 janë raste që rezulton të na drejtohen për herë të parë me kërkesë.

Lëndët e rasteve të tilla janë përgaditur dhe dërguar për ID- të furnitorit (futje në sistem) veprim ky pa të cilin nuk mundë të procesohet një pagesë nga subvencioni.

Tabelë krahasuese e shtimit të kërkesave në dy vitet e fundit dhe tremujorin e 2016-tës shprehur në përqindje si dhe përqindja e rasteve të reja nga perioda eparë 2016.

| Viti | Perioda tremujore | Kërkesa më tepër se në vitet parprake dhe rstet e reja nga numri i përgjithshëm në vitin 2016 | Rritja në( %) sipas periodave të njejta të viteve të ndryshme dhe rasteve të reja në 2016. | Vërejtje! |
|---|---|---|---|---|
| **2016** | **182** | **43** | **23.6%** | |
| **2015** | **122** | **60** | **32.9%** | |
| **2014** | **90** | **72** | **39.5%** | |

## Zyra për Shëndet Publik

- Gjatë periudhes kohore Janar-Mars 2016, në kuadër të zyrës për Shëndet publik, janë zhvilluar nje sërë aktivitetesh që kanë pasur për qëllim monitorimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse si dhe edukimin e popullatës përmes seminareve që për qëllim kanë pasur ruajtjen e shëndetit nga faktor të ndryshëm të ambientit si dhe mbajtja e ligjeratave nëpër shkolla të mesme të komunës lidhur me abuzimin e substancave psikoaktive.
- Monitorimi i sëmundjeve ngjitëse është bërë te banorët e fshatrave Cërnicë, Zhegër, Nasalë, Lladovë, Shurdhan, ku poashtu janë vizituar qendrat dhe punktet e mjekësisë familjare dhe janë bërë konsultimet me stafin mjekësor.
- Për ditën botërore të ujit është mbajtur një ligjeratë me temën – 'Uji dhe Shendeti' si dhe është vizituar penda Përlepnicës ku për së afërmi jemi njoftuar lidhur me gjendjen e ujit të pijshëm si dhe analizat kimiko bakteriologjike. Po ashtu janë shpërndarë broshura nxënësve dhe popullatës që për temë ka pasur ruajtjen e ujit të pijshëm si resurs i rëndësishëm natyror.
- Me organizatën joqeveritare të Komunes sonë 'Handikos' janë mbajtur takime pune lidhur me mbrojtjen e shëndetit të personave me nevoja të veqanta si dhe te drejtat ligjore në fushën e shëndëtsisë.
- Për shkak të të reshurave të mëdha të shiut në Komunën tonë është bërë vizitë në lokacionet ku ka pasur ndotje të ujit të pijes që shfrytëzohen nga puset në fshatin Nasalë, Uglar, Dobërqan, Pogragjë për të konstatuar gjendjen shëndetësore të banorëve të këtyre zonave si dhe problemet që mund të jenë me prejardhje hidrike.
- Është konstatuar se probleme shëndetësore nuk ka pasur si pasojë e përdorimit të ujit nga se shumica e banorëve që kanë pasur probleme me puse kanë qenë të ndihmuar nga Hidromorava me anë të cisternave me ujë të pijes njëherit është rekomanduar që uji që

shfrytëzohet nga puset të vlohet para se të përdoret në amvisëri si dhe të bëhet klorizimi i puseve.

- Paraqitja e sëmundjeve në regjionin tonë vjen si pasojë e kushteve të pavolitëshme higjeniko sanitare të një pjese e popullatës, problemi i furnizimit jo të rregullt me ujë higjienike, standardi i ulët jetësor, niveli i ulët i edukatës shëndetësore të një pjese të popullatës etj. Është mbajtur takim në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik në Prishtinë lidhur sëmundjet ngjitëse, parandalimin si dhe trajtimin i tyre.

- Në kuadër të zyrës për Shëndet Publik poashtu janë udhëzuar për Ministrinë e Shëndetësisë në bazë të rekomandimit të mjekëve konziliar të QKU-së 34 raste për trajtim jasht vendit edhe atë me sa vijon:

| Nr. | Lloji i sëmundjes | Numri i kërkesave | Të rekomanduara në Ministrinë e Shëndetësisë |
|---|---|---|---|
| 1 | Sëmundje kardiovaskulare | 12 | 12 |
| 2 | Sëmundje oftalmologjike | 6 | 6 |
| 3 | Sëmundje onkologjike | 4 | 4 |
| 4 | Sëmundje ortopedike | 6 | 6 |
| 5 | Sëmundje neurologjike | 4 | 4 |
| 6 | Sëmundje Hematologjike | 2 | 2 |
| | Gjithsejt | 34 | 34 |

## INSPEKSIONI SANITAR

**Raport Janar-Mars 2016**

| | | |
|---|---|---|
| **Kontrollime** | **120** | |
| **Procesverbale** | **54** | |
| **Pëlqime sanitare** | **7** | |
| **Denime – Ligji i Duhanit** | **26** | |
| **Fletëparaqitje – Ligji i Duhanit** | **18** | |

Gjatë kësaj periudhe kryesisht janë kontrolluar :

<u>-subjektet tregtare ushqimore,</u>

<u>-subjektet hoteliere,</u>

<u>-Institucione para Shkollore dhe ato Shkollore</u>

<u>-Institucione private Shëndetësore.</u>

**Institucione private Shëndetësore**, kontrollohen në bazë të kërkesave të palëve për lëshimin e **Akvendimit për Pëlqimin Sanitar** si fazë e licencimit të Ordinancave në M.SH.

Gjatë kësaj periudhe është ndërmarrë një seri e aksioneve në asistencë **të P.K ( Policisë së Kosovës),** në **zbatim të Ligjit per kontrollin e Duhanit**, **janë shqiptuar 26 dënime mandatore** dhe janë ngritur **18 Fletëparaqitje për Kundërvajtje** për palët të cilat nuk i kanë shlyer denimet në afatin e caktuar.

Me përmirësimin e konditave klimatike do të ketë ngritje të aktivitetit të Inspeksionit Sanitar.

## -Zyra për Ujë

**(** *Monitoron -përcjelljen e kualitetit të ujit të pijshëm)*

Gjatë periudhës Janar –Mars ka realizuar xhiron e parë të hulumtimit të kualitetit të ujit të pijshme në institucionet shkollore dhe shëndetësore

Ka realizuar ne ne 8 vendbanime –lokacine rurale me 32 mostra uji per analize

-Në 11 objkete shkollore- Shkolla

-Në 4 Objekte shëndetësore-Ambulanta

-Në 1 rast në objekt publik burimi , Baja në Miresh Rezultate për ujin e pijshëm në lokacionet e hulumtuara rezultojnë në standardet minimale të lejuara të ujit për pije .

-Gjatë kësaj periudhe kohore zyra për ujë është marrë edhe me situatën e vërshimeve e cila si pasojë ka shkaktuar rritje të nivelit të lumenjëve dhe ndikimin në ujin e pijshëm në disa lokacione banuese të cilat janë në afërsi të lumenjëve që janë në komunën e Gjilanit

Vizitë e përbashkët ekipore nga DSHMS janë realizuar në fshatin Nasalë ,Uglar, Pogragjë, Miresh etj

-Vërshimet kanë ndikuar në disa lokacione siq janë në fshatin Nasalë dhe Uglar

-Dhe furnizimi me ujë të pijshëm në ato situata është bërë nga Hidromorava përmes cisternave deri ne stabilizim të situatës

-Familjet e prekura janë në Nasalë janë gjithsejt ---- 12 familje

-Familjet e prekura nga vërshimet në Uglar janë ---- 6 familje

Kurse ne fshatin Pogragjë dhe Miresh në vizitën e bërë nuk ka pasur familje të prekura nga vërshimet

-DSHMS në situata emergjente ka bashkëpunuar me QRSHP dhe me KRUK 'Hidromorava' me të cilat ka hasur në mirëkuptim- bashkëpunimi duke ofruar staf dhe mjete teknike te bashkëpunimit për situata eventuale

## ***Rekomandimi i masave të dhëna për veprim***

Banorët paraprakisht duhet të bëjnë pastrimin e puseve me mjete teknike (Motorë uji) disa herë të mundshme dhe më pas të bëhet klorizimi respektivisht dezinfektimi I ujit ,

Pas nje stabiliteti të të reshurave dhe rënia e nivelit të lumit Morava rekomandohet që të ndërmerren hapa për rehabilitimin e këtyre puseve në mënyrë që të furnizohen me ujë të pijshëm banorët e fshatrave të prekura nga vërshimet

Këto rekomandime janë dhënë në vendin, lokacionet e prekura nga vërshimet gjatë vizitës zyrtare.

Përmes Mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të DSHMS dhe KRUK Hidromorava Ju kemi dhënë listën e Familjeve të perkeura nga vërshimet respektivisht për trajtim dhe reahabilitin e ujit në puse

Kompania Hidromorava permes Zyrtarve dhe mjeteve teknike ka marrë në përgjegjësisi të kryej dhe realizojë masën e rehabilitimit të puseve për familjet e prekura nga vërshimet

-Zyra për ujë gjithashtu vazhdon bashkëpunimin e ngushtë me QRSHP në Gjilan

-Vazhdon bashkëverprimin në teren përmes mostruesit, duke marrë mostra uji në institucionet shkollore dhe shëndetësore për hulumtimin e ujit të pijshëm

-Zyra për ujë në vazhdimësi përcjell dhe monitoron situatën e përgjithshme të kualitetit të ujit të pijshëm në komunën e Gjilanit, si dhe jep masa rekomandimi. Pas vlerësimit të situatës me ujë të pijshëm, varësisht nga situata! Mund të jep masa rekomanduese për të mbrojtur dhe përmirësuar gjendjen me ujë të pijshëm, gjithnjë jepen masa preventive qoftë ato të udhëzimit teorik, por edhe masa në raste të caktuara të vlerësimit për udhëzimin e veprimit praktik me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik. Nga mundësia e paraqitjes së ndonjë sëmundje epidemike që mund të vijë nga uji jo i pijshëm apo i ndotur!

# RAPORTI TRE MUJOR QPS GJILAN

**JANAR----MARS .2016**

**Emri dhe mbiemri i koordinatorit të SAS-itUD.RAMADAN MURTEZI**

| | *Aktivitetet* | Kategoria 0 | Kategoria 1 | Kategoria 2 | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| APLIKIMI | 1. Nu. i rast. që kanë aplik. për herë të pare. | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | 1.1+1.2+1.3 | Kategoria 0+1+2 |
| | | 12 | 53 | 49 | 114 | |
| | Sa prej tyre janë të aprovuara | | 45 | 38 | 83 | |
| | Sa janë në shqyrtim | 3 | 5 | 5 | 13 | |
| | Sa prej tyre janë të refuzuara | 9 | 3 | 6 | 18 | |
| RIAPLIKIMI | 2. Nr. i rast. te larguara per mos ri-aplikim | | 5 | 1 | 6 | Kkat. 0+1+2 |
| | 3. Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar | | 558 | 127 | 685 | |
| | 4. Numri i rast. të larguar për mungesë të dokumentacionit | | 27 | 15 | 42 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| VERIFIKIMI | **5.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara** | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | 1+2+3+4 | Kat. 0+1+2 |
| | | 12 | 643 | 210 | 865 | |
| | **5.1. Sa prej tyre janë aprovuar** | 1.1+3 | 1.1+3 | 1.1+3 | 1.1+3 | |
| | | | 608 | 183 | 791 | |
| | **5.2.Sa janë refuzuar/çregjistruar** | 1.3+2+4 | 1.3+2+4 | 1.3+2+4 | 1.3+2+4 | |
| | | 10 | 30 | 22 | 62 | |
| | **5.3. Sa janë në procedurë e sipër** | 2 | 5 | 5 | 12 | |
| | | / | / | / | / | |
| KOM. MJEKËSOR | **6. Nu. i rast. të dërgu. në Komi. Mjek.(KM)** | 6.1+6.2+6.3 | 6.1ë45v v +6.2+6.3 | 6.1+6.2+6.3 | 6.1+6.2+6.3 | Kat. 0+1+2 |
| | | | 254 | 14 | 268 | |
| | **6.1. Numri i rasteve të aprovuara nga KM** | | 244 | 9 | 253 | |
| | **6.2. Numri i rasteve të refuzuara nga KM** | | 5 | 4 | 9 | |
| | **6.3. Numri i rasteve të kthyra nga KM për kompletim dokumentacioni** | | 5 | 1 | 6 | Kat. 0+1+2 |
| ANKESAT | **7. Numri i ankesave të paraqitura . nga Shfrytëzuesit** | A+B+C | A+B+C | A+B+C | A+B+C | Kat. 0+1+2 |
| | | | 4 | 8 | 12 | |
| | **A. Në shkallë të parë( I )** | a1+a2+a3 | a1+a2+a3 | a1+a2+a3 | a1+a2+a3 | |
| | | | / | 8 | 8 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a) 1. Ankesa të pranuara | | / | 2 | 2 | |
| | a) 2. Ankesa të refuzuara | | / | / | / | |
| | a) 3. Ankesa në procedurë e sipër | | / | 6 | 6 | |
| | B. Në shkallë të dytë(II ) | b1+b2+b3 | b1+b2+b3 | b1+b2+b3 | b1+b2+b3 | |
| | | | 4 | / | 4 | |
| | b) 1. Ankesa të pranuara | | / | / | / | |
| | b) 2. Ankesa të refuzuara | | / | / | / | |
| | b) 3. Ankesa në procedurë e sip. | | 4 | / | 4 | |
| | C. Kontestet në Gjykata | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | C1+c2+c3 | |
| | | | / | \ | \ | |
| | c) 1. Kontestet të pranuara | | | | | |
| | c) 2. Konteste të refuzuara | | | | | K 0+1+2 |
| | c) 3. Konteste në procedurë e sip. | | | | | |

**Aktivitetet tjera: Janë dhënë 47 vërtetime palëve që nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale.**

**Janë dhënë 33 vërtetime palëve që janë shfrytëzues të ndihmës sociale, Janë dhënë 13 vërtetime për botën e jashtme, 18 vërtetime për KEK, dhe 8 vërtetime për destinime të tjera, 1 Vertetim për student, për tre muaj gjithësejt janë dhënë 123 vertetime.**

**Janë pranuar 12 ankesa të palëve, nga shkalla e parë kanë qenë 8 ankesa, prej tyre 2 ankesa janë aprovuar, kurse 6 ankesa kanë mbetur në procedurë, për shkallen e dytë kanë qenë 4 ankesa, ku të gjitha janë në procedurë të shqyrtimit.**

**Ësht mbajtur komisioni mjekësor ku kanë qenë 268 lëndë, ku prej tyre janë aprovuar 253 lëndë, 9 lëndë janë refuzuar, kurse 6 lëndë kanë mbetur në procedurë të plotësimit të dokumenteve.**

**Është kryer riaplikimi, ku kanë qenë 685 lëndë për riaplikim, kanë qenë 114 kërkesa të reja, prej tyre janë aprovuar 83 kerkesa, kurse 18 kërkesa janë rrefuzuar, 13 kërkesa kanë mbetur në pracedurë, kurse 42 lëndë janë ndërprerë.**

## QENDRA PËR PUNË SOCIALE

## GJ I L A N

**RAPORTI MUJOR I SHËRBIMEVE SOCIALE PËR MUAJIN JANAR-MARS 2016**

| Nr. | **Kategoria e shfryt.** | **Nr.i rast.** | | **Llojet e intervenimit** | **Rezultate të arritura** | **Vërejtje** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Shërbimet Rezidenciale** | **Të vjetra** | **Të reja** | | | |
| 1.1. | Kujdestaria për rastet e veçanta. | 2 | 3 | Kërkese për caktimi i kujdestarit te përkohshëm | Caktimi i kujdestarit te përkohshëm | Gjykata ka kërkuar caktimi<br><br>n e kujdestarit te përkohshëm nga QPS |
| 1.2 | Strehimi në shtëpi me bazë në komunitet. | 4 | | Vizite përcjellëse ne Shtëpinë integruese Gjilan | Përcjellje e rastit | I vendosur pa kohe te caktuar |
| 1.3 | Strehimi i viktimave të dhunës në familje. | | | | | |
| 1.4 | Strehimi i viktimave të trafikimit. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.5 | Vendosja në institucione të mbrojtjes sociale Shtëpi të Pleqve Prishtinë | 7 | 1 | 6. Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjar,vlerësimi i kërkesës,<br><br>. | Përcjellja e gjendjes se te moshuarve përmes vizitave dhe konsultimeve, | |
| 1.6 | Të trajtuarit e shëndetit mendor të kateg.të ndry. | 2 | | Bashkëpunim me QSHM | Njoftim QSHM për rastet,trajtimi shëndetësor | Ka kryer vepër penale,<br><br>dëmtim i pasurisë se huaj |
| **2.** | **Shërbimet familjare** | | | | | |
| 2.1 | Fëmijët e braktisur te porsalindur | 4 | 1 | 3. Vizitë përcjellëse e rasteve të vjetra të vendosura në strehim familjarë, sesion këshillues individual familjarë.<br><br>1. Periode paraadoptuese | 3. Fëmijët në gjendje të mirë shëndetësore, kompensimi material nga MPMS me rregull. | 1.Femije eshte adoptuar<br><br>Lende aktive 4 |
| 2.2 | Fëmijët me sjellje asociale | 101 | 6 | 1. Vizite shtëpiake,sesione këshilluese individuale familjare-raste te reja | 1. Janë udhëzuar te ushtrojnë mbikëqyrjen prindërore ndaj fëmijës se tyre. | |
| 2.3 | Abuzimi seksual i të miturve jashtë familjes | 2 | | | | |
| 2.4 | Kujdestaria për të mitur | | | | | |
| 2.5 | Kujdestaria për të rritur. | 24 | 3 | 2. Vizite përcjellëse ,sesione këshilluese individuale familjare, | 2. Konsultime me pale,familjar, përgatitja e raporteve, | |
| 2.6 | Bashkimi familjar | | | Vizite,konsultime,sesion këshillues ,ndihme e përgjithshme për fëmijët, | Vazhdimi edhe me tutje me vizita dhe kontaktime te rregullta, | |
| 2.7 | Birësimi me element vendor | 9 | 1 | 1 Kërkesë e re ne procedure te vlerësimit,<br><br>1. Familje ne procedure te rivlerësimit, | 1. Rekomandimi nga DPSF Prishtine për fëmijën nga QPS Kamenice, | Dërgimi i dosja ne Panel për Aprovim. |
| 2.8 | Birësimi me element ndërkombëtar. | // | // | ////////////////////////////////////////////// | | |
| 2.9 | Strehimi në familjet | 20 | | 3. Vizite përcjellëse rasteve te vjetra ne | 3. Vizite përcjellëse | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | farefisnore. | | | strehim,<br><br>2. Pushimi Kujdestarisë | rasteve,sesione këshilluese individuale,familjar,konsultime për rastet | |
| 2.10 | Fëmijët nën Kujdestari | 33 | 3 | 7. Vizita familjare,sesione këshilluese individuale,familjare,konsultime për rastet, | 7 Vlerësimi i kërkesës-caktimi i kujdestarit te përkohshëm-fëmijë jetim. | 1 ka arrit moshën madhore,largohet nga regjisri |
| 2.11 | Strehimi në familjet alternative. | 3 | 1 | 4. Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual familjar,përcjellje e rasteve pa përkujdesje princore te vendosura ne familje strehuese alternative. | 4. Vazhdimi i bashkëpunimit QPS-Familje strehuese dhe fëmijë. | Përcjelle e rasteve |
| 2.12 | Shërbime për reintegrimin e viktimave të trafikimit. | | | | | |
| 2.13 | Shërbime për viktima të dhunës në familje. | 56 | 15 | 2. Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjar,ndihme e e përgjithshme për klientin, | 2. Vazhdim i bashkëpunimit dhe kontakteve lidhur me rastin. | Përcjellja e rastit |
| 2.14 | Ndihmë në rregullimi e marrëdhënieve bashkëshortore. | 195 | 8 | 1. Vizite shtëpiake-sesione këshilluese individuale,familjare,konsultime për rastin-rast ne procedure te vlerësimit | 1. Vazhdimi i bashkëpunimit-procedure te shkurorëzimit-ndarjes. | Kontaktim prind fëmijë me marrëveshje, |
| 2.15 | Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve. | | 5 | 1. Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjar,dhënia e mendimit për besimin e fëmijës dhe lejimin e kontaktit prind fëmijë. | 1. Ne pritje te aktvendimit . | |
| 2.16 | Dhënia e mendimit për martesa të të miturve. | | | ////////////////////////// | ////////////////////////////////////////// | |
| 2.17 | Persona me nevoja të veçanta. | | 1 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.18 | Ndihmë në realizimin e kontakteve prind-fëmijë. | 20 | | 4. Mbikëqyrje e kontaktit prind fëmijë<br><br>vikend te nena biologjike me marrëveshje. | 10. Kontaktimi prind fëmijë janë realizuar me sukses, | |
| 2.19 | Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer. | | | | | |
| 2.20 | Fëmijët me aftësi të kufizuara. | 162 | 3 | -Kërkesa te reja,plotësimi aplikacionit, konkluzes,përgatitja për KM. | 2Bashkëpunim me prindërit dhe fëmijët<br><br>3 Fëmijë kanë arrit moshën madhore, janë larguar nga lista e pagesës,këshillohen prindërit ti referojnë te pensionet për te rritur. | 3 raste te reja per vitin 2016 |
| **3** | **Shërbimet e komunitetit** | | | | | |
| 3.1 | Fëmijët në punë | 17 | | 6. Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjar,it, | 6. Sesione këshilluese individuale,familjare,ne procedure te tërheqjes se fëmijëve nga punët e rrezikshme, | |
| **4.** | **Bashkëpunim me institucionet Publike.** | | | | | |
| 4.1 | Shërbime për fëmijë në konflikt me Ligjin. | 189 | 45 | 13,Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjare | Sesion këshillues individual, familjar ,udhëzime për mos kryerjen e veprave dhe mbikëqyrjes prindërore,<br><br>dërgimi i raportit social gjykatës | |
| 4.2 | Prezantim në seanca Gjyqësore-Prokurori | | 43 | .Prezantim ne seance gjyqësore,për te mitur,dhune ne familje si dhe adoptime. | | |
| 4.3 | Prezantim në Polici. | | 27 | . Pjesëmarrje ne seance-intervistim ne polici,te mitur, | Pas intervistimit te gjithë te miturit lirohen | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **5.** | **Shërbimet Tjera** | | | | | |
| 5.1. | Konsultim me palë | | 620 | .Konsultime te ndryshme lidhur me rastet ne QPS,rastet e reja dhe atyre nen përcjellje-monitorim. | | |
| 5.2. | Vizita- familje, spital, QSHM, OJQ-ët etj | | 241 | Vizitat shtëpiake,ne institucione për rastet e reja,te vjetra dhe me kolege. | | |
| 5.3 | Vizita institucionale | | 23 | Bashkëpunim me spitalin për raste sociale. | | |
| **6.** | **Shërbimet Administrative** | | | | | |
| 6.1 | **Klient tjerë**:Vërtetimet konstatimet zyrtare etj: | 76 | 260 | Klient tjerë, vërtetime, konstatime zyrtare etj. | | |
| 6.2 | Shkollat | | 7 | Raste te referimit-bashkëpunimit me shkollat. | | |
| 6.3 | Futja e rasteve ne bazën e te dhënave | | 260 | Futja e rasteve te reja ne bazën e te dhënave dhe shërbimeve e intervenimeve ne rastet e vjetra | | |
| 6.4 | DPSF-Prishtine | | 20 | 3. Njoftime –Panelit etj | | |
| 6.5 | Bashkëpunim me QSHM | | 1 | 1. Pas punës ne rast vlerësojmë se rasti ka nevoje për referim për trajtim ne QSHM ne Gjilan. | | |
| 6.6 | Bashkëpunim me Familjet strehuese | | 11 | Bashkëpunim me familjet strehuese,konsultim për gjendjen e fëmijëve,pagesat etj. | | |
| 6.7 | Seminar | | 3 | Menaxhimi i Shërbimeve sociale ne nivel Lokal,Organizuar BE dhe MPMS. | | |
| 6.8 | Bashkëpunim me QPS | | 9 | Kontaktime për qeshte e adoptimit fëmijë-familje.. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.9 | MVPT-Prishtine | | 5 | Konsultime lidhur me rastin social | | |
| 6.10 | SOS Fshati Prishtine | | 5 | Referohen 5 fëmijë jetim për vendosje ne SOS | | |
| 6.11 | Bashkpunim me Raiffeisen,ETC | | 2 | | | |
| 6.12 | Raport MPMS Shkurorezimet | | 1 | Sipas kerkeses se MPMS Prishtine | | |

# Raport pune për 3 mujorin e vitit 2016, QKMF 'Dr.Nagip Rexhepi'–Gjilan

## Hyrje

Duke u bazuar në planin e punës së QKMF-së për vitin 2016 dhe rolin e saj si ofruese e shërbimeve shëndetësore për popullatën e Komunës sonë, paraqesim këtë raport për 3 mujorin e pare te këtij viti .

**1.Vizitat për 3 mujorin e pare te vitit 2016 ne QKMF"Dr.Nagip Rexhepi" Gjilan**

| | Shërbimet | Totali | Referimet | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Totali i vizitave** | 74523 | **10154** | **13.62%** |
| 2 | Vizita në mjekësinë familjare | **47442** | **8770** | **18.4%** |
| 3 | **Vizita në emergjencë** | **10292** | **1337** | **12.99** |
| 4 | **Vizita shtëpiake (urgjenca)** | **522** | | |
| 5 | **Vizita stomatologjike** | **7740** | | |
| 6 | **Shërbime laboratorike** | **7107** | | |
| 7 | Ingjeksione | **28680** | | |
| 8 | Infuzione | **2284** | | |
| 9 | Kujdesi Paliativ | **155** | **11** | **7%** |
| 10 | Qendra e diabetit | **1265** | **36** | **2.84%** |
| 11 | Vizita Psikologjike | **350** | | |
| 12 | Participimi i përgjithshëm (Fletepagesa) | **11265** | | 19.51% |

## 2. Infrastruktura dhe pajisjet

- Mirëmbajtja dhe funksionimi optimal i objekteve ekzistuese.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e aparaturës dhe pajisjeve ekzistuese.
- Në bazë të planifikimit të prokurimit për QKMF "Dr Nagip Rexhepi "për furnizimin me paisje të nevojshme për punë ne shpresojmë se do të kemi mundësinë e furnizimit me të njejtat të cilat veq i kemi paraparë për të gjitha Qendrat dhe sherbimet mbrenda tyre me të cilat mjete ne e konkretizojmë punen tonë dhe janë më se të nevojshme për ofrim të shërbimeve shëndetësore e gjithashtu edhe për cilësin e tyre.

## 3. Aktivitetet

- Kemi filluar me zbatimin e statutit të ri të aprovuar nga Kuvendi komunal Gjilan , i cili perfshinë disa ndryshime në raport me statutin e me hershem.

- Në muajin **janar kemi filluar zbatimin e projektit të bashkëpunimit mes Komunës së Gjilanit , MSH-së dhe Karitas Kosoava** , për pranimin e një numri të caktuar të punëtorëve shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve dhe kujdesit shtesë për familjet në nevoj në Komunën e Gjilanit duke përfshirë si zonat urbane ashtu dhe ato rurale.

- Në muajin **shkurt pikërisht me datë 16.02.2016** , është **bërë emrëtimi i QKMF –së** dhe është zbuluar pllaka e vendosur me mbishkrimin QKMF "Dr.Nagip Rexhepi"

- Gjithashtu në **muajin shkurt** kemi filluar me projektin e kontrollave sistematike per nxenesit e shkollave fillore te Komunes se Gjilanit dhe jemi duke e bere vleresimin e gjendjes shendetesore te tyre nga ekipet e Mjekesise familjare dhe Stomatologjike , ku cak i ketyre vleresimeve jane nxenesit e klaseve **(te para, pesta dhe te nenta**). Projekt i cili vazhdon nga viti i kaluar per te vleresuar gjendjen shendetesore te nxeneseve te kesaj komune dhe do te percillen disa gjenerata, ku ne baze te rezulatateve te dala ne do t'i orientojme politikat shendetesore .

- Gjatë këtij **tre mujori janë mbajtur 6 ligjerata** në kuadër të qendrës së trajnimit për edukim të vashdueshem profesional me mjek dhe infermiere , me tema profesionale kurse nga grupi i infermereve për edukim në komunitet janë shënuar aktivitetet si vijon:

- **Muaji Janar** - mbajtja e nje ligjerate me teme:"Adoleshenca dhe shendeti ", me nxenesit e shfmu "Rexhep Elamzi " Gjatë ligjeratës snxënësëve u janë shpërnda fletëpalosje për sëmundjet seksuale transmisive , njëkohsisht janë dhënë edhe këshilla për higjenën personale.

- **Në muajin Shkurt** - është bërë këshillimi i pacientëve në komunitet gjegjësisht nëpër mabulanca te Mjekesise Familjare me temën "Planifikimi familjarë " ku është bërë këshillimi për përdorimin e kontraceptivëve si dhe njekohesisht u është me dije se edhe nëpër të gjitha qendrat tona ofrojmë kontraceptiv falas si: kondoma , depo proverë dhe prevent kontraceptiv emergjent.

- **Me daten 24 , Mars 2016**, nën organizimin e UNICF-it,dhe me pjesëmarjen e Kryetarit të Komunës si dhe Ministrit të Shëndetësisë ëshët mbajtur Konferenca me tëmën:"Vizitat shtëpiake dhe përkujdesja e nenës dhe fëmijëve " ku janë sjellur përvojat nga pesë Komuna të cilat veq kanë filluar me këtë projekt . Nga **Kryetari Haziri** morëm mbështetjen e plotë për fillimin e këtij projekti në Komunë n ë Gjilanit.
- **Në muajin Mars** është shënuar dita Botërore e TBC-së. Grupi i infermiereve për edukim në komunitet kane zhvilluar aktivitete në pika të ndryshme të qytetit dhe në Qendrat Tregtare , duke kontribuar në dhenjen e informatave për qdo qytetar të rastit në lidhje me kete sëmundje .